

MONITOR:

ZBATIM I REFORMAVE URGJENTE PRIORITYRE

Periudha: 15.12-30.12.2015

Zbatimi i marrëveshtjes politike

Dinamika e aplikimit të marrëveshtjes Politike është rrënuar. Është shtuar tenzioni në mesin e Partive Politike pjemarrëse në bisedimet politike. Takimi i fundit i grupeve punuese u mbajt më 17 dhjetorë. Pritet që bisedimet të vazhdojnë pas festave të vitit të ri, kurse është paralajmëruar dhe vizita e Komesarit Han për janar të vitit 2016.¹

Edhe nëse arihet njëfar pëlqimi për pikat e mbetura, parashtrohet pyetja serioze vallë do të mund të të krijohen kushte për mbajtjen e zgjedhjeve të drejta të parakohshme. Thelbësoshtë, Marrëveshtja nuk plotësohet “plotësishtë dhe konstruktive” siç ishte potencuar dhe me Qëndrimet e Këshillit të Ministrave për punë të përgjithshme të UE-së, mbajtur më 15 dhjetorë.²

Në mënyrë plotësisht vihen në pikpyetje dhe vendimet e kontraktuara. Deputeti nga rradhët e VMRO-DPMNE –së Antonio Milloshovski, deklaroi se partija e tij ka “qfaqur rezervë serioze” ndaj veprimit të Prokurores speciale Katica Janeva.³ Mosmarrëveshtjen në mes të Ministrave dhe Zëvendësve të tyre nga rradhët e VMRO-DPMNE –së dhe LSDM –ës, thellohen. Ministria për punë dhe politikë Sociale nga rradhët e LSDM –ës Frosina Remenski dha Padi Penale për keqpërdorim të funksionit dhe pozitës, për paudhësitë gjat punës së tij për para ardhësin e tij Dime Spasov, përndryshe Zëvendës Minisër i përhershëm dhe plotësues nga rradhët e VMRO-DPMNE-së.⁴ LSDM –ja dorzoi Padi deri në Gjzkatën Administrative kundër përbërjes së mëparshme të KSHZ-ës, për shkak të mospasjes ingerenca për venim marrje për mosmarrëveshtjen midis Minitrit për financa Yoran Stavrevski, dhe Zëvendës Ministrit plotësues nga rradhët e LSDM-ës Kire Naumov.⁵

Nga ana tjetër, të shpeshta janë debatet publike dhe vizitat mesinstitucionale të dedikuara për aplikimin e prioritetëve për Reforma urgjente, por pa rezultate të dukshme.⁶

Sundimi i së drejtës dhe gjyqësori

Gjyqësori

Prokurorija publike për ndjekjen e veprave penale të lidhura me dhe që dalin nga përmbajtja e ndjekjes së paligjësme të komunikimeve, Katica Janeva, kërkoi shtyrje të afatit për lëndën “Puç” e caktuar për datë 21 dhjetorë. Në eleborimin thuhet se shkak për anulimin dhe shtyerjen e afatit bëhet për shkak të njohtimit detajik të përgjithshëm me përmbajtjen e dëshmive të cilat i janë dorzuar gjykatës, të cilat nuk iu kan dorzuar dhe nuk janë pjesë

¹ Han me letër deri tek liderët- paralajmëroi vizitë për ate që është punuar sipas marrëveshtjes në Przhino...TV Nova 22.12.2015, e gjeni në: <http://novatv.mk/index.php?navig=8&cat=2&vest=26319>.

² Qëndrimet e Këshillit të Ministrave për punë të përgjithshme në UE i gjeni në: <http://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-15356-2015-INIT/en/pdf>.

Ndër të tjerat, Këshilli apelon për realyim te plotë dhe konstruktiv të Marrëveshtjes nga të gjitha palët, në përputhje me kornizën e marrëveshtjes kohore si dhe caqet, në interes të shtetit dhe qytetarëve. Njëkohësishtë, Këshilli e potencon rëndësinë të zgjedhjeve në Prill 2016, viti, që të jenë të realyuar në mënyrë kredibile. Këshilli, e përsërit thirrjen drejtuar të gjitha palëve ta rrespektojnë premtimin e tyre për aplikimin në mënyrë urgjente të reformave prioritare, për zgjidhjen e problemit të pushtetit sitemorë dhe drejtësisë, kyçur dhe thyerjet e të së drejtave themelore, pavarësija e gjyqësorit, lirija e medias, zgjedhjet, korrupsioni, politiyimi i institucioneve shtetërore, shkrirëja e shtetit në partit në pushtet, dhe mëngësitë ndaj kontrollit dhe mbikqyrjes të shërbimeve inteligjente.

³ Janeva u shëndrrua në një instrument në duart e Zoran Zaevit ...Veb faqja e VMRO-DPMNE-së 25.12.2015, e gjeni në: <http://vmro-dpmne.org.mk/?p=28618>.

⁴ Remenski parashtror Padi Penale kundër Spasovit...MIA, 28.12.2015, e gjeni në: <http://www.mia.mk/mk/Inside/RenderSingleNews/134/132964460>.

⁵ Është dorzuar Padi kundër vendimit të ish KSHZ-ës... Uep faqja e LSDM-ës, 22.12.2015, e gjeni në: <http://www.sds.org.mk/default.aspx?mld=55&agld=2&articleId=13224>.

⁶ Këshilli nacional për Eurointegrime më datë 24 dhjetorë mbajti një debat publik për “Reformat urgjente prioritare për Republikën e Maqedonisë”. Më tepër informata do gjeni në: http://www.sobranie.mk/2014-002cea30-a5b8-435e-ad55-147ff64cbfa2-ns_article-javna-rasprava-za-itnite-reformski-prioriteti-za-republika-makedonija.nsp.

Sekretarijati për çështje evropjane, në suaya të iniciativës pçr vizita institucionale me qëllim për mbikqyrjen e reformave prioritare Urgjente, realizoi takime me përfaqësues të Ministrisë për shtetërore dhe Administratë, Ministrinë e Punëve të Brëndëshme, Komisionin Shtetërorë Zgjedhorë, Ministrinë e drejtësisë dhe Komisionin shtetërorë për pengim të Korrupsionit. Për më shum informata në: : <http://www.sep.gov.mk/content/?ID=784#.VolZUegrldU>; <http://www.sep.gov.mk/content/?ID=787#.VolZT-grldU>; <http://www.sep.gov.mk/content/?ID=788#.VolZTegridU>; <http://www.sep.gov.mk/content/?ID=789#.VolZSugridU>; <http://www.sep.gov.mk/content/?ID=792#.VolZS-grldU>

përbërse e kësaj lënde që i është dorëzuar. I akuzuari Zoran Zaev u paraqit në seancën e caktuar. Seanca e rradhës çshtë caktuar më datë 14 janarë 2016.⁷

Prokurorija për ndjekjen e veprave të lidhura dhe që dalin nga përmbajtja e ndjekjeve të paligjshme të komunikimeve (prokurorija speziale publike) më 25 dhjetorë deklaroi se në rrjedhë janë më shumë veprime parahetimore për lëndët që kanë obligim të vërtetë. Në ndërkohë, edhe një herë u kërkua nga LSDM që ti dorëzonte matrijale të cilat ka në pronë, duke shtuar se një pjesë të Prokurorëve u është dhënë certifikati për punë me informata të klasifikuara të gradës “fshehtësi Shtetërore”. Gjatë kërkesës paraprake, nga LSDM paralajmëruan se nuk do të përgjigjen kërkesës për dorëzimin e matrijaleve pëderia sanuk sigurohen kushte maksimale për ruajtjen e tyre në vend të sigurtë, që do të thotë dhe sigurim 24 orësh që për mmentin mu ka sepse nuk është sjell një krigj i tillë për Prokurori.⁸ Zoran Zaev në 30 dhjetor i dorëzoi matrijale të përgjimeve në prokurorinë speciale publike, midis të cilave është dhe matrijali i rastit “Monstra”.⁹

Këshilli penal pran Repartit për kriminalitet të organizuar dhe korrupsion pranë Gjykatës themelore Shkup 1-Shkup, në bayë të propoyimit për ndërprerjen e masës së paraburgimit të të akuzuarve Zoran Verushevski dhe Gjorgji Llazarevski dorëzuar përmes mbrojtjes së tyre, dhe me apsorbinim dhe konkretizimin e mendimit pozitiv dhe propozimin e propurores speciale Katica Janeva¹⁰, vendosi që ta ndërpret masën e paraburgimit, nga që si masa për kujdes propoyohen lëviya e kufiyuar nga shëpija dhe vendi i banimit, dhe marja e dokumentacionit për udhëtim jashtë vendit, Pasaportës.¹¹

Kuvendi i RM në 30 dhjetor e miratoi propozim ligjin për të punësuarit në shërbimin publik zyrtar të Prokurorisë publike për hetim të veprave penale të lidhura dhe të cilat janë pasojë e përmbajtjes të ndjekjes të paligjshme të komunikimeve, të paraqitur nga Qeveria me procedurë të urgjente.¹² Propozimi fillimisht ishte i paraqitur nga ana e grupit të deputetëve nga rradhët e LSDM, PRSD, PLD dhe PDT, por nuk ariti në rendin e ditës për shkak se deputetët të VMRO-DPMNE votuan kundër, me pretekst se kjo materyje është më e rregulluar me ligjet të tjera për prokurori publike, shërbesë të prokurorisë publike dhe administratë dhe me ligjin e propozuar kjo prokurori do të jetë në pozitë privilegjuar.¹³

Qeverija dorëzoi Propozim-ligj për ndryshim dhe plotësim të ligjit për Pagat e Prokurorëve publik, si dhe për pagat e gjyqtarëve, me procedurë të shkurtuar.¹⁴ Me propozimet e ligjmerisë vendimtare, parashikohen shtesa plotësuese themeltare për pagata.¹⁵ Lartësija dhe mënyra e verifikimit të shtesave rregullohet me Akt të Keshillit Gjygyjsorë të Republikës së Maqedonisë, ose Prokurorisë publike të RM, pas pëlqimit paraprak nga Ministrija e Financave.

Në reagimin e sajë, Prokurorja speciale publike Janeva çmoi se me rregulloren që e autorizon Prokurorin publik të RM-ës, me pëlqimin paraprak të Ministrisë së Financave të vendos me shtesat për Prokurorët publik në këtë Prokurori publike, thyhen principet e vendosura për autonomi të kësaj prokurorije dhe të pavarësisë financiare masandej. Qeverija dorëzoi Propozim-ligj me plotësime, që shkakton se shtesat, lartësija e tyre dhe mënyra e verifikimit me akt të Prokurorit publik që po udhëheq me ate në mënyrë Analoge, e njejta po parashihet dhe për prokurorin publik që po menaxhon me Prokurorinë themelore për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Janë propozuar dhe ndrzhshime në lidhje me **Ligjin për Akademinë e gjykatësve dhe Prokurorëve** në sferën e kritereve për pranin në stërvitjet fillestare.¹⁶ Parashihet mundësija që bashkçpunorët profesional me provim shtetërorë

7 Nga monitoringu i aktivitetëve të Kualicionit “Të gjithë përgjizim të drejtë”

8 Konferenca për shtyp: Për momentin PSP nuk ka kushte për mbrojtjen e matrijaleve...Veb faqja e LSDM –ës 17.12. 2015, i gjeni në: <http://www.sdsm.org.mk/default.aspx?mld=55&agld=6&articld=13189>.

9 LSDM i dorëzoi matrijale deri në Prokurorinë Speciale. MIA. 30.12.2015. e gjeni në: <http://www.mia.mk/mk/Inside/RenderSingleNews/282/132968741>.

10 PSP ka propozuar ndërprerjen e paraburgimit për Verushevskin, MIA 25.12.2016, i gjeni në: <http://www.mia.mk/mk/Inside/RenderSingleNews/380/132962131#>.

11 Lajmërim për opinjonin Gjzkata themelore Shkup 1 Shkup 29.12.2016, e gjeni në: <http://www.osskopje1.mk/Novosti.aspx?novost=438>.

12 Matrijalin e seancës e gjeni në: <http://www.sobranie.mk/sessiondetails.nsp?sessionDetailsId=514ae52a-f803-4ef7-9096-92fb31766def&date=30.12.2015>.

13 Kuvendi miratoi më shumë ndryshime dhe plotësime të ligjeve nga lëmitë të ndryshme. MIA. 21.12.2015 e gjeni në <http://www.mia.mk/mk/Inside/RenderSingleNews/381/132953583>.

14 Matrijale të përgjithshme janë vendosur në: <http://www.sobranie.mk/materialdetails.nsp?materialId=d22bc200-1622-4dd7-9428-a6893925c922> dhe <http://www.sobranie.mk/materialdetails.nsp?materialId=e274859b-52a8-4434-b9ba-3f28685dca8f>

15 Neni 1 nga Propozim-ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Pagat e gjykatësve parashikon të shtohen dy nene të reja 7-a dhe 7-b. Me rregulloren 7-a shohet e drejta në shtesa në rastet kur gjykatësi punon më gjatë nga koha e punës, dhe punës gjatë ditëve të festave, që me rregullat e deritanishme ligjore nuk është rregulluar si e drejtë e garantuar që takon me ligj; me rregulloren 7-b do të aplikohet e drejta për shtesa në Paga për gjykatësit në kushte të veçanta, gjatë rrezikut në punë dhe besueshmërisë gjatë punës.

Me nenin 1 nga Propozim ligji për plotësim dhe ndryshim të ligjit për Pagat e Prokurorëve publik përshkruhet se në koeficientin e Pagave të Prokurorëve cilit udhëheqin në repart të Prokurorisë, shtohet 0,2. Me keto plotësime të ligjit barazohet koeficienti i zmadhimit të prokurorit publik i cili udhëheq me repart të prokurorisë publike me koeficientin për rritjen e Pagave të gjykatësve të cilit janë kryetarë të sektoreve apo segmenteve të gjykatës. Analoge e neni 1 nga Propozim-ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Pagat e Gjykatësve, me neni 2 shtohen dhe dy nene të tjera, 6 – a dhe 6 – b të cilit shkaktojnë shtesa të njëllajshme në lidhje me Pagat e Prokurorëve publik. Me nenin 3 propozohet konpenzim për kujdestari. Në bazë të elaborimit, caku themelorë është përforcimi i pavarësisë së Gjykatësve dhe pavarësimi i Prokurorve publik.

16 Matrijale të përgjithshme janë në: <http://www.sobranie.mk/materialdetails.nsp?materialId=7741c21f-b641-46b1-bde6-6e2f659f6c78>

gjyqësorë me mesatare 7.00 të cilit më pak se 5 vite punojnë në gjyqësi dhe prokurori të pranohen në kursin fillestarë në Akademinë për gjykatës dhe prokurorë publik, por vetëm si kandidat për prokurorë publik.¹⁷

Të gjitha ligjet të propozuara ishin të miratuara në seancën e Kuvendit të mbajtur në 30 dhjetor.¹⁸

Prokurorija themelore në Shkup, duke vepruar në bazë të lëndës për falsifikim të mundshëm të kartave të identitetit, deklaroi se është gjetur puntoria e fshehtë ku është bërë falsifikimi i dokumenteve, nga ku janë arrësuar 3 persona, por egzistojnë indicje dhe për persona të tjerë të involvuar dhe për kryerjen dhe të veprave të tjera penal.¹⁹

Mbas kontrollit të parë të 22 letër njoftimeve për të cilat është përcaktuar se janë të lëshuara në mënyrë të paligjshme²⁰, **Ministri për punë të brendshme, Oliver Spasovski** deklaroi se gjatë hetimit janë zbuluar edhe 424 raste për lëshim të paligjshëm të letër njoftimeve të personave të cilat figurojnë si votues në Listën zgjedhore.²¹

Në opinjon ishin përhapur lloj lloj informatash dhe sqarimesh nga ana e partive VMRO²² dhe LSDM²³ për inplikime të "palës tjetër" në këtë aferë që shkaktoi huti dhe spekulime në opinjon. Në seancën të mbajtur në 30 dhjetor, Kuvendi e pranoi Propozim-vendimin për formim të Komisionit anketues për rastin "Fabrika për falsifikim të letër njoftimeve, pasaportave dhe dokumenteve të tjera", e përkrahur nga ana e deputetëve nga rradhët e VMRO-DPMNE, BDI dhe PDSH.²⁴

Këshilli gjyqësorë në Republikën e Maqedonisë në seancën e mbajtur më datë 24 dhjetorë, solli vendim për zgjedhjen e krzetarit të gjykatës themelore të Strugës dhe për 34 jurorës në Gjykatën themelore të Shkup 1 Shkup. Profesori Simeon Gelevski si kandidat i vetëm, më 28 dhjetorë është zgjedhur si anëtarë i këshillit për verifikimin e fakteve dhe për ngritjen e iniciativës për verifikimin e përgjegjësisë për gjykatës nga rradhët e të pensionuarve profesor univerzitar.²⁵ Përmbajtja e këti trupi akoma nuk është kompletuar me anëtarë nga rradhët e profesorëve, nga përfaqësues të bashkësive që nuk janë shumicë, sepse asnjë nga kandidatën e paraqitur deri më tani, nuk i ka plotësuar kushtet. Në seancë konsultative ky trup, Sasho Pocevskin e ka zgjedhur si kryetarë nga rradhët e Avokatëve të pensionuar.²⁶

Komisioni evropjan për demokraci përmes drejtësisë (Komisioni i Venedikut) më 21 dhjetorë e solli mendimin e vet për ligjet në lidhje me përgjegjësinë dicipinare dhe vlersimin e gjykatësve, më konkretisht në relacion me propozim ndryshimet nga viti 2015 që dedikohen ligjit për gjykatat, ligjit për Këshillin gjyqësor të RM-ës, si dhe për ligjin tani më të miratuar për Këshillin për verifikimin e fakteve dhe ngritjen e iniciativës për përgjegjësi të gjykatësve. Komisioni e vleron si problematike situatën, se iniciativa për ndryshimin e Kushtetutës, ligjet dhe tekstet përkatëse janë sjell dhe votuar nga ana e koalicionit në Pushtet, përderisa partit kryesore opoyitare ishin jasht Parlamentit. Është potencuar se reformat e këtilla me rëndësi, në kushte normale duhet të gjejnë një mbështetje të gjërë politike, në të kundërtën egziston rrezik se opinjoni do të dallojë (me të drejtë apo jo) si tentim i shumicës pushtetare ti formojë organet e sapoformuara, dhe përmes tyre të vendoset kontrolli mbi gjyqësorin.²⁷

17 Në bazë të sqarimit, këto ndryshime janë të motivuara nga nevoja për përforcimin e pavarësisë dhe mvetësisë të prokurorisë publike , si dhe rritjen e profesionalizmit, realizimin profesionist dhe kulmorë të funksionit të prokurorisë, ndërsa në këtë mënyrë tejkalohet problem të nevojës së patjetrësueshme për plotësimin e vendeve të zbrazura në prokurorinë publike me që do mundësohet veprimi i suksesëshëm i mëtutjeshëm të realiyimit të ligjit për përgjegjësi Penale.

18 Kuvendi miratoi tre zgjidhje ligjore nga lëmia e gjyqësisë. MIA. 30.12.2015 e gjeni në: <http://www.mia.mk/mk/Inside/RenderSingleNews/381/132968107>.

19 Është zbuluar puntorija e fshehtë për falsifikimin e dokumentave të identitetit. Veb faqja e PPRM, 19.12. 2015 , e gjeni në: <http://jorm.gov.mk/?cat=4>.

20 Pres konferenca e ministrit Spasovski: Persona pa vendbanim kanë marur letër njoftime dhe kan qen pjesë e listës zgjedhore të MPB. 23.12.2015 e gjeni në: <http://www.mvr.gov.mk/vest/1143>.

21 Letër njoftimet të paligjshme të banorëve të Pustecit me adresë të banesave në pronë të RM. Ueb faqja e MPB. 30.12.2015 e gjeni në <http://www.mvr.gov.mk/vest/1186>.

22 Zaevi përsëri është kapur në kriminalitet deri në fyt...Veb faqja e VMRO-DPMNE –së, 22.12.2015, gjindet në: <http://vmro-dpmne.org.mk/?p=28596>. GP e VMRO-DPMNE –së propoyon fotmimin e komisionit Anketues për fabrikën e kartave të identitetit të LSDM –ës...Veb faqja e VMRO-DPMNE-se, 28.12.2015, gjindet në: <http://vmro-dpmne.org.mk/?p=28631>.

23 Vonë është për Gruevskin,...nuk ka ikje për krimet...Veb faqja e LSDM –ës, 22.12.2015, e gjeni në: <http://www.sds.org.mk/default.aspx?mld=55&agld=2&articleId=13236>.

Zaevi: Gruevski përsëri bën regji, mafija gjindet në qeveri...Veb faqja e LSDM-ës, gjindet në: <http://www.sds.org.mk/default.aspx?mld=55&agld=6&articleId=13231>.

Gruevski dhe Jankillovska në skandalin me shtypjen dhe dhënjën e letrave të identitetit...Veb faqja e LSDM-ës, 23.12.2015, gjindet në: <http://www.sds.org.mk/default.aspx?mld=55&agld=2&articleId=13251>.

24 Do të formohet Komisioni anketur për "Fabrika për letër njoftime të falsifikuara". MIA. 30.12.2015. e gjeni në: <http://www.mia.mk/mk/Inside/RenderSingleNews/380/132968315>.

25 Në bazë të rezultateve të njësuara nga votimet, komisioni i formuar në suaza të Këshillit gjyqësorë i RM, vërtetoi se gjatë zgjedhjeve të mbajtura nga 573 gjykatës të regjistruar në lisen e gjyqësorit, 502 nga ata kan votuar. Nga numri i përgjithshëm i gjykatësve që kan votuar, për Simeon Gelevskin kan votuar 435, nga të cilit 67 fletvotime kan mbetur të pa vlevshme, Lajmërim. Veb faqja e KGJRM, 29.12. 2015, gjindet në: <http://www.sds.org.mk/default.aspx?mld=55&agld=2&articleId=13251>.

26 Nga aktivitetet e monitoringut të institutit për të drejtat e njeriut.

27 Nga aktivitetet e monitoringut të institutit për të drejtat e njeriut.

Komisioni ka vërejtje për formimin e **Këshillit për verifikimin e fakteve dhe ngritjen e iniciativës për përgjegjësi të gjykatësve**, paraqet ndryshim radikal në krahasim me shtrirjen e mëparshme institucionale. Në përputhshmëri me nenin 105 të Kushtetutës, këshilli gjyqësorë është ai që sjell vendime për përgjegjësin disiplinore të gjykatësve. Komisioni i Vendeikut potencon se nuk është në gjendje ta çmojë kushtetutshmërinë e këti trupi të ri, sepse kjo është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë. Megjithatë, mendimi që jepet nuk është në favor të formimit të një trupi të ri të veçantë për përgjegjësi disiplinore dhe propozohet që funksionet e Këshillit për përcaktim të fakteve dhe të fillimit të procedurës për përcaktim të përgjegjësisë të gjyqit që të kthehen në Këshullin gjyqësor, me që antarët e Këshillit gjyqësor të cilat do të jenë të involvuar në fazën fillestare të inicimit të procedurës disiplinore të mos marrin pjesë në vendim sjelljen e përgjegjësisë disiplinore. Plotësisht, thekson se ekziston mungesë e përcaktuar e koherencës midis reformave kushtetuese të cilat filluan në vitin 2014 dhe amandamentet ligjore të vitit 2015. Komisioni konsideron se këtyre reformave duhet tu qaset sistematikisht, si në nivel kushtetues ashtu edhe në atë ligjdhënës.²⁸

Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut në 10 dhjetor për rastin Asllani kundër RM²⁹, me të cilën përcaktohet se Republika e Maqedonisë është e përgjegjshme për shkeljen e nenit 3 të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe liritë themelore – Ndalesë e torturës, trajtim johuman ose degradues dhe dënim

Komisioni për pyetje Evropiane pranë Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, në 23 dhjetor u mbajt debat publik në temën: Si deri në gjyqësi evropiane?, në të cilën ishin të ftuar edhe përfaqësues të shoqërisë civile, ndër të tjerash dhe antarët e Rrjetit 23.³⁰

Mbas ngjarjes të mbajtur konsultative, e organizuar nga ana e Ministrisë e drejtësisë, në lidhje me Propozim-strategjinë për reforma të sektorit gjyqësor, përgaditësit kërkuan nga anët e interesuara të japin kontribut ekspertik për tekstin final të propozimit. Instituti për të drejtat e njeriut (IÇP), organizatë antare e Rrjetit 23, përgaditi komentare dhe vërejtje në lidhje me Propozim-strategjinë në përgjithësi por dhe për kapituj të veçanta.³¹

Ndjekja e komunikimeve

Puna e Komisionit anketues për skandalin me përgjimet edhe më tej është e bllokuar për shkak të mos pajtimeve me anëtarët e sajë. Pika e vetme e për të cilën aritën marrëveshje është formimi i dy grupeve punuese për vizitë të institucioneve dhe kompanive të cilat mund ti kenë informatat për skandalin me përgjimet.³² Nuk ka informacionet vallë janë të shqyrtuara vizitat e planifikuara gjatë periudhës 22-24 dhjetor (njëri grup punues duhesh të realizojë vizitë të institucioneve dhe kompanive të cilat posedojnë pajisje teknike e cila do të mundet të përdoret për përgjime, duke i kyçur dhe operatorët mobil; grupi tjetër i punës duhesh të vizitojë gjykatat dhe prokuroritë).

Komisioni për pyetje të zgjidhjeve dhe emërimeve e propozoi Ivan Ivanov, deputet nga radhët e VMRO-DPMNE-së për antar të Komisionit anketues për skandalin me përgjimet, në vendin e Sillvana Bonevës, të cilës i mbaroi mandati si deputete mbasi u bë antare e KSHZ-së.³³

Në seancën e caktuar për 17 dhjetor, ishte parashikuar ndëgjim i ministrit e finansave, Zoran Stavrevski. Dëshmitari u paraqit, por seanca nuk u mbajt. Presidenti i Komisionit anketues, Petre Shilegov, vendosi që ta ndalojë seancën për shkak të kërkesës së Stavrevskit të dëshmojë mbas dyerve të mbyllura, me sqarim se seanca do të vazhdojë në momentin kur dëshmitarët do të vendosin të flasin publikisht.³⁴ Në pres-konferencën, Shilegovi njoftoi pyetjet që ishin të dedikuara për dëshmitarin.³⁵

28 OPINION ON THE LAWS ON THE DISCIPLINARY LIABILITY AND EVALUATION OF JUDGES OF "THE FORMER YUGOSLAV REPUBLIC OF MACEDONIA" Adopted by the Venice Commission at its 105th Plenary Session (Venice, 18-19 December 2015), Strasbourg, 21 December 2015 Opinion No. 825 / 2015.

29 Vendimin e gjeni në [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"sort":\["kupdate Descending"\],"documentcollectionid2":\["GRANDCHAMBER","CHAMBER"\],"itemid":\["001-159060"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{).

30 Debat publik në temë: Si deri në gjyqësinë Evropiane? Ueb faqja e Kuvendit të R të M. 23.12.2015 e gjeni në http://www.sobranie.mk/2014-002cea30-a5b8-435e-ad55-147ff64cbfa2-ns_article-javna-rasprava-na-tema-kako-do-evropsko-sudstvo.nsp.

31 Komentare dhe vërejtje të Propozim-strategjisë për reformat në sektorin e gjyqësorit 2016-2020 nga Instituti për të drejtat e njeriut. Ueb faqja e IÇP. 28.12.2015. e gjeni në: <http://www.ihr.org.mk/mk/pocetna/242-2016-2020.html>.

32 Vazhdim i seancës nr. 4 të Komisionit anketues për skandalin me përgjimet: Formimi i grupit punues për vizitë të institucioneve të lidhura me punën e Komisionit, në përputhje me Planin për punë të Komisionit anketues për skandalin me përgjimet. Ueb faqja e Kuvendit të RM. 16.12.2015 e gjeni në: <http://www.sobranie.mk/sessiondetailsrabortni.nsp?sessionDetailsId=f375b1cc-4c34-4773-93ff-f1b61338c4fa&date=16.12.2015>.

Grupet punuese të Komisionit anketues për përgjimet në vizitë të institucioneve dhe kompanive. MIA. 16.12.2015

E ofrueshme në <http://www.mia.mk/mk/Inside/RenderSingleNews/381/132946598#>.

33 Ivanov në vend të Bonevës në Anketën të përgjimeve. MIA. 16.12.2015 e gjeni në:

<http://www.mia.mk/mk/Inside/RenderSingleNews/381/132946681>.

34 Stavrevski erdhi, por nuk ishte i ndëgjuar nga Komisioni anketues. MIA 17.12.2015 e ofrueshme në

<http://www.mia.mk/mk/Inside/RenderSingleNews/50/132949114>

35 Shilegov: Ja prej se frikëzohet Stavrevski të përgjigjet para publikut. Ueb faqe e LSDM. 17.12.2015 e ofrueshme <http://www.sdsm.org.mk/default.aspx?mld=55&agld=6&articleId=13185>.

Komisionet kuvendore për mbikqyrje mbi shërbimeve të inteligjencës³⁶ nuk mbajtën seancë në periudhën raportuese.

Reforma zgjedhore

Mbas shqyrtimit të Kodit për përvçaktim të mënyrës dhe hapave të zgjedhjes të sekretarit gjeneral të KSHZ³⁷, në 24 dhjetor Komisioni shpalli shpallje publike për mbushje të kësaj pozite.³⁸ Kandidatët për sekretar gjeneral, midis të tjerave, duhet të jenë zyrtarë administrues nga kategorija e punëtorëve menaxheriale dhe kështu të mos jenë antarë të ndonjë organi të partie politike. Sekretari gjeneral i KSHZ do të menaxhojë me sektorin informativ të kompetencë të cilit do të jetë menaxhimi i listës zgjedhore. Në shpalljen janë paraqitur 14 kandidatë, kurse seanca për zgjidhje ishte e paralajmëruar për 30 dhjetorin.³⁹

Violeta Duma antare e KSHZ nga LSDM, mbas 12 ditë të kaluara në detyrë, në 30 dhjetor është larguar për shkak të përmbylljes të kushteve për pension. Për të plotësuar vendin KSHZ nga LSDM do të ketë shpallje publike.⁴⁰

Aktivitetet e KSHZ, para të gjithash në pjesën e menaxhimit dhe azhurimit të Listës zgjedhore, duhet të fillojnë mbas zgjedhjes të Sekretarit gjeneral dhe anëtarëve nga rradhët e LSDM, paisja me personal teknik dhe pajisje të përshtatshme. Mbetet paqartë vallë ky trup do të ketë sukses ti përballojë sfidat, duke mare parasysh ingjericitetë e zmadhuara përreth ndryshimeve në Kodin zgjedhor.

Depolitizimi i administratës publike

Në konferencën përfundimtare mbas për shkak të mbylljes së tving projektit “Përkrahja e reformave në shërbimin shtetëror dhe administratën publike” **Ministerja për Shoqëri informatike dhe administratë, Marta Arsovska Tomovska**, theksoi se një nga qëllimet e këtij projekti është të sigurojë rekomandime për përgaditje të regjistrimit të popullsisë, i cili do të gjeneronte informata precise për të gjithë individët të cilat jetojnë në teritorin e Republikës të Maqedonisë, si dhe ata të cilat jetojnë jasht kufijve të sajë. Regjistri i këtillë do të shfrytëzohet si bazë për sigurim efikas të shërbimeve të sektorit public, por dhe njëkohësisht për përgaditje të listave zgjedhore, regjistrim të popullsisë dhe statistikë demografike, ose “në qoftë se kualiteti i këtyre është i mirë, regjistri i popullsisë do të mund ta ndërtojë regjistrimin e popullsisë”.⁴¹

Mosmarrëveshjet në Ministrinë për shoqëri informatike dhe administratë vazhduan. **Zavendës ministri nga rradhët e LSDM, Aleksandar Kiracovski**, deklaroi se në njësitë kalimtare dhe përfundimtare nga Ligji për zyrtarë administrative nuk është shënuar se vlerësimi në vitin e parë është pilot project, qëndron shumë qartë se vetëm proceduar e filluara do të përfundohen sipas ligjit fillestar për zyrtarë shtetërorë, kurse vlerësimi për vitin 2015 është filluar në muajin shtator të këtij viti, 7 muaj mbasi ligji i ri është në zbatim. Kiracovski mbeti në qëndrimin se gjithë qeverija për vendosje të zgjidhjeve të këtyra është që të bëjë presion dhe shantazh mbi administratën⁴² dhe deklaroi se deputetët nga rradhët e opozitës do të paraqesin një propozim-ligj për shtyrje të zbatimit të sistemit të vlerësimit deri në vitin 2017.⁴³ Nga Ministrija për shoqëri informatike dhe administratë përsëri dërguan reagim, duke pohuar se zgjidhjet ligjore janë të sjellura në përputhje me merit sistemin, me qëllim të vendosjes të sistemit efikas të shërbesës publike dhe përparimit të shërbimeve.⁴⁴

Ministri për punë të brendshme, Oliver Spasovski, në 30 dhjetor deklaroi se për shkak të mangësive serioze gjatë punës, janë të ndëruar krerët e pesë sektorëve të MPB në më shumë qytete, si dhe shefi i SVR Shkupit. Arsya për ndryshimin e shefit të SVR Shkupit është mosrespektimi i rasteve të sulmeve ndaj gazetarëve dhe ndërhyrja e policisë në UKIM gjatë bllokadit të Rektoratit nga ana e përfaqësuesve të Plenumit studentor dhe organizatës rinore “Mugra”.⁴⁵

36 Komisioni për mbikqyrje të pubës të Agjencionit kundër zbulimorë dhe Agjencionit të inteligjencës dhe Komisionit për mbikqyrje mbi shqyrtimin e masës hetuese të veçantë të komunikacioneve nga ana e Ministrisë së punëve të brendshme, Policia financiare, Drejtorisë së doganës dhe Ministrisë të mbrojtjes.

37 Rregullatori i përvçaktimeve të mënyrës dhe procedurës për zgjidhje të Sekretarit gjeneral të Komisionit shtetëror zgjedhor është e ofrueshme në ueb faqen e Sekretarit gjeneral të KSHZ: <http://www.sec.mk/index.php?lang=mk>.

38 Shpallje publike për Sekretar gjeneral të Komisionit shtetëror zgjedhor

39 Deri në momentin e shpalljes të këtij raporti, nuk ka informacion a është i zgjedhur Sekretari gjeneral i KSHZ.

40 Do të zgjidhet anëtarë i ri i KSHZ, në vendin e Violeta Dumës. MIA. 29.12.2015 e ofrueshme në:

<http://www.mia.mk/mk/Inside/RenderSingleNews/282/132966397#>.

41 Projekti ishte i finansuar nga Unioni Evropian, përmes Instrumentit për ndihmë para-aderuese (IPA), në kohëzgjatje të 12 muajve. Konferenca përmbyllëse për shkak të mbylljes së tving projektit të finansuar nga BE. Ueb faqja e MIOA. 16.12.2015. e ofrueshme:

<http://www.mio.gov.mk/?q=node/4098>.

42 Pres konferenca; Kiracovski: Gruovski filloi të tërhiqet. Ueb faqja e LSDM. 17.12.2015. e ofrueshme në:

<http://www.sds.org.mk/default.aspx?mld=55&agld=6&articleId=13184>.

43 Kiracovski kërkon që të shtyhet sistemi për vlerësim të administratës. MIA. 29.12.2015. e gjeni në:

<http://www.mia.mk/mk/Inside/RenderSingleNews/381/132966659#>.

44 Reagimi i MIOA. Ueb faqja e MIOA. 17.12.2015. e ofrueshme në: <http://www.mio.gov.mk/?q=node/4110>.

45 I ndëruar shefi i SVR Shkupit: Arsya është ndërhyrja në UKIM dhe sulmet mbi gazetarët. Nova TV. 30.12.2015. e gjeni në: <http://novatv.mk/index.php?naviq=8&cat=2&vest=26460>.

Media

Negociatat mbi **reformat në mediat** janë të ngrira. Në taimin e mbajtur në 17 dhjetor, mediatori Vanhoute kërkoi nga partitë politike të paraqesin propozime konkrete për reforma në sferën e mediave, para të gjithash nga aspekti i ndikimit të tyre mbi zgjedhjet e ardhshme.⁴⁶

Organizatat e mediave mbetën të zëshëm në kërkesat për kyçe në negociata dhe ndryshim të trajtimit të ekipave të gazetarëve që e ndjekin procesin. **Sindikati i pavarur i gazetarëve të Maqedonisë (SSNM)** reagoi për injorancën për gazetarët, që në kontinuitet përsëritet.⁴⁷ Nga Sindikati theksojnë se me një marrëdhënie të tillë politika tregon se sa i vlerëson qytetarët e sajë dhe të drejtën të tyre të jenë të informuar, për shkak se ajo nuk është marrëdhënie vetëm për kah gazetarët dhe mediat, por edhe për publikun të përgjithshëm. Për shkak të kësaj, SSNM kërkon nga të gjithë politikanët dhe institucionet të mundësojnë kushte elementare për punë të ekipeve gazetare, duke kujtuar se në mënyrë të fuqishme do ta ngrenë zërin e tyre para publikut shtëpiak dhe ndërkombëtarë për trajtimin të këtyllë të punëtorëve mediatik.

Presidenti i Bashkësisë të gazetarëve të Maqedonisë (ZNM), Naser Selmani, deklaroi se negociatat janë të bllokuara duke fajësuar partitë politike, për shkak se mediat janë instrument veçanërisht i rëndësishëm në qeverisjen e tyre dhe pa departizimin e mediave nuk ka kushte për zgjedhje fer. Ai theksoi se në projektligjin të propozuar nga mediatori Vanhoute janë të inkorporuara propozimet nga të gjitha faktorët, por VMRO-DPMNE bën shtypje mbi Vanhoute që të braktisë pikat kryesore të tijë. Sipas Selmanit, nevojitet presion i fuqishëm ndërkombëtarë për ndryshime sistematike në sektorin mediatik.⁴⁸

46 Vanhoute kërkoi propozime konkrete nga partitë për sferën e mediave. Tellma. 17.12.2015. e gjeni në: <http://www.telma.com.mk/vesti/vanhoute-pobara-konkretni-predlozi-od-partiite-za-mediumskata-sfera>.

47 Reagimi i trajtimit të ekipave të gazetarëve që i ndjekin negociatat. Ueb faqe e SSNM. 16.12.2015. e gjeni në: <http://ssnm.org.mk/reaktsija-na-tretmanot-na-novinarskite-ekipi-shto-gi-sledat-pregovorite/>.

48 Selmani – Qeverija don në zgjedhje me qytetarë të gënijer. Radio Evropa e Lirë. 27.12.2015. e ofrueshme në: <http://www.makdenes.org/content/article/27448845.html>.